

# Udhëzues për kthimin në punë të punonjësve

Duhet të ndiqen protokollet e duhura pas karantinimit ose izolimit të punonjësit për të ulur rrezikun e përhapjes së COVID-19 në vendin e punës.

## **KUR DUHET TË KARANTINOHEN PUNONJËSIT?**

Në se udhëtojnë jashtë Masaçusetsit brenda 10 ditëve të fundit ose janë ekspozuar ndaj dikujt që është COVID-19 pozitiv, edhe në se nuk kanë shfaqur simptoma dhe nuk kanë dalë pozitiv.

## **KUR DUHET TË IZOLOHEN PUNONJËSIT?**

Në se testohen pozitiv për COVID-10 OSE kanë simptomat e COVID-19 (edhe të lehta).

## **KUR MUND TË KTHEHEN NË PUNË**

Të gjithë punonjësit në izolim ose karantinë nuk duhet të kthehen në punë po që se nuk plotësojnë kriteret e mëposhtme:

<b>NË SE PUNONJËSI ISHTE NË KARANTINË</b>	<b>NË SE PUNONJËSI ISHTE NË IZOLIM</b>
<p><b><u>Për shkak të ekspozimit të njohur</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Pas karantinimit për një kohë të caktuar*</li><li>• <b><i>Për punonjësit e shëndetësisë, reaguesit e parë dhe punonjësit e infrastrukturës kritike:</i></b><ul style="list-style-type: none"><li>• Disa punonjës të sektorit mund të vazhdojnë të punojnë gjatë karantinës për të ruajtur funksionet kritike <b>vetëm në se nuk kanë simptoma.</b></li><li>• Punonjësit duhet të mbajnë të paktën një maskë si dhe veshjet e duhura shtesë PPE dhe të vetë-monitorojnë simptomat</li></ul></li></ul> <p><b><u>Për shkak të udhëtimit jashtë MA</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Karantinhuni për 10 ditë* OSE tregoni një rezultat negativ të COVID-19.</li></ul>	<p><b><u>Simptoma të buta - të mesme</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Të paktën 24 orë pa temperaturë (pa temperaturë - duke ulur ilaçet); dhe</li><li>• Të paktën 10 ditë qysh prej fillimit të simptomave; dhe</li><li>• Përmirësimi i simptomave</li></ul> <p><b><u>Simptoma të rënda (kërkon shtrim në spital)</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Punonjësit duhet të konsultohen me një ekspert të sëmundjeve ngjitëse</li><li>• Izolohuni deri në 20 ditë</li></ul> <p><b><u>Asimptomatik</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Të paktën 10 ditë që nga data e testit të parë pozitiv për COVID-19; dhe</li><li>• Nuk janë zhvilluar simptoma pasuese</li></ul>

**Punëdhënësit nuk duhet të kërkojnë rezultatin e testit të COVID-19 dhe as shënimin e mjekut për punonjësit që janë të sëmurë që të vërtetojnë sëmundjen, të kërkojnë leje ose të kthehen në punë.**

**\* \*Për hollësi të mëtejshme për kohën e karantinës bazuar në testin ose simptomat, Vizitoni [mass.gov/QUARantineTime](https://mass.gov/QUARantineTime)**

Për më tepër informacion lidhur me karantinën dhe izolimin, vizitoni [mass.gov/isol8](https://mass.gov/isol8)

